LIGJ
Nr.10 165, datë 15.10.2009

PËR PËRCAKTIMIN E MOSHËS SË DALJES NË PENSION TË PUNONJËSVE TË NËNTOKËS

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Punonjësit e nëntokës, me periudhë pune të klasifikuar në kategorinë e parë, sipas dispozitave të kreut I të vendimit nr.526, datë 20.12.1958 të Këshillit të Ministrave "Për ndarjen e punës në kategori, për efekt pensioni", të ndryshuar, kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie kur:

a) arrijnë moshën 60 vjeç;

b) kanë periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet, nga të cilat jo më pak se 15 vjet punë në nëntokë.

Neni 2

Pensioni llogaritet sipas rregullave të përcaktuara për pensionet e pleqërisë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 3

Efektet financiare të këtij ligji, deri në mbushjen e moshës, sipas nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6313, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi